



A.nr.744/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.744/2026, të datës 06.07.2026, të parashtruar nga ankuesja E.GJ, të cilin me autorizim i përfaqëson Avokat A.K, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.744/2026, e datës 06.07.2026, e parashtruar nga ankuesja E.GJ.

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr. 01-120/01-27692 i datës 12.06.2026, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës.

A r s y e t i m

Ankuesja E.GJ, (*tutje referuar vetëm ankuesja*), përmes përfaqësuesit të saj më datë 06.07.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 01-120/01-27692 të datës 12.06.2026, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, lidhur me refuzimin e kërkesës për kompensimin retroaktiv të diferencës së shtesës së përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, për periudhën 05.02.2023 deri më datë 31.12.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.07.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjakovës, ndërsa, kjo e fundit më datë 14.07.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2957/2026 të datës 06.07.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 01-120/01-27692 të datës 12.06.2026, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; Kërkesën e datës 29.05.2026 e parashtruar nga ankuesi tek Komuna e Gjakovës; Autorizimin e datës 02.04.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.07.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 14.07.2026; Akt Emërimit e datës 14.05.2024 të ankuesit; Listë pagave për ankuesen janar-korrim 2026; Kopjen e ID-së së ankuses.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, **sepse:**

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se sipas akt emërimit me Nr. 01-112/01-7432, të datës 14.05.2024, ankuesja është e punësuar në pozitën Inspektor i Tregut në Komunën e Gjakovës.

Ankuesja më datë 29.05.2026, i është drejtuar me kërkesë Komunës së Gjakovës, për kompensimin e diferencës së vlerës sipas përvojës së punës nga 0.25% tani e tutje në 0.5% nga data 05.02.2023 deri më datë 31.12.2025.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjakovës përmes Menaxherit të Burimeve Njerëzore, më datë 12.06.2026 ka nxjerr Vendimin me Nr. 01-120/01-27692, me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankueses me arsyetimin se nuk ka juridiksion të trajtojë ne merita kërkesat e tilla për shkak se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka bërë plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të Pagave sipas Aktgjykimit K079/23 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 01-120/01-27692 të datës 12.06.2026, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, pretendon se pa drejtë po i mohohet e drejta për kompensimin e vlerës së përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, nga koha kur ha hy në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publikë deri më datë 31.12.2025, sepse i është cenuar një e drejtë e fituar, sepse kjo e drejtë i është njohur me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kërkon që ankesa të aprovohet, të anulohet vendimi i kontestuar dhe të detyrohet Komuna e Gjakovës, që të bëjë kompensimin të diferencës së pagës sipas përvojës së punës nga 0.25% tani e tutje në 0.5% nga datës 05.02.2023 deri më datë 31.12.2025, me kamat prej 8%.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesve referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”*, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;...ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa*

(ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkritazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë **në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi.** Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e paragrafi 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë, kështu që, pretendimi ankimor mbi rrethanat ekzistuese nuk ka mbështetje ligjore, ndërsa vendimi i kontestuar përkatësisht Vendimi me Nr. 01-120/01-27692 i datës 12.06.2026, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, është në përputhje të plotë me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.744/2026, datë 23/07/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses ,Av.A.K;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.